

June 2022

Legal Alert Albania



## Miratimi i “Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025”

Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025 e miratuar në datë 26/05/2022, është në linjë me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale të çdo subjekti.

Kjo Strategji pritet të përbëjë një element thelbësor në progresin e mëtejshëm social ekonomik, në rritjen e konkurrencës së ndershme dhe krijimin e besueshmërisë në treg dhe përmban një grup rregullash, të cilat synohen të implementohen nga institucionet e përfshira në sistemin e Pronësisë Intelektuale (PI) për të inkurajuar dhe forcuar zhvillimin, menaxhimin dhe mbrojtjen e PI-së në nivel kombëtar, në këtë mënyrë duke vendosur dialog gjithëpërfshirës ndërmjet aktorëve të ndryshëm.

Qëllimi i saj është të stimulojë zhvillimin ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend, të sigurojë një funksion të duhur të tregut të brendshëm duke vendosur ekuilibrin e duhur midis interesave të pronarëve të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe interesave të përdoruesve dhe forcimi i sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së pronës intelektuale.

Nëpërmjet kësaj Strategjie, rezultatet që pritet të arrihen janë:

- Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe legjislativ në fushën e pronësisë intelektuale;
- Forcimi i kapaciteteve administrative të institucioneve të përfshira në sistemin e PI-së;
- Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut (organizimi i seminareve, konferencave dhe aktiviteteve promovuese);
- Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve të përfshira në fushën e PI-së;
- Forcimi i sistemit të zbatimit dhe të mbrojtjes së PI-së;
- Nxitja dhe hartimi i politikave për regjistrimin e Treguesve Gjeografikë dhe Emërtimeve të origjinës si aset dhe interes kombëtar;
- Komercializimi i objekteve të PI-së si edhe transferimi i teknologjisë.

## The approval of “The National Strategy for Intellectual Property 2022-2025”

The National Strategy for Intellectual Property 2022-2025, approved on 26/05/2022, is in line with the fulfillment of the obligations arising from the Stabilization and Association Agreement (SAA) for the alignment of Albanian legislation with the *acquis* and the respect for intellectual property rights of each subject.

This Strategy is expected to constitute an essential element in further social economic progress, in increasing fair competition and creating credibility in the market and contains a set of rules, which are intended to be implemented by the institutions involved in the Intellectual Property (IP) system to encourage and strengthen the development, management and protection of IP at the national level, thus establishing a comprehensive dialogue between different actors.

Its purpose is to stimulate economic, scientific and cultural development in the country, to ensure a proper functioning of the internal market by establishing the right balance between the interests of the owners of intellectual property rights and the interests of users and strengthening the system of registration and protection of intellectual property.

Through this Strategy, the expected outcomes are as follows:

- Improvement of the regulatory and legislative framework in the field of intellectual property;
- Strengthening the administrative capacities of the institutions included in the IP system;
- Increasing the level of public awareness (organization of seminars, conferences and promotional activities);
- Strengthening cooperation and coordination between institutions involved in the IP field;
- Strengthening the IP enforcement and protection system;
- Promotion and drafting of policies for the registration of Geographical Indications and Appellations of origin as assets and national interest;
- Commercialization of IP facilities as well as technology transfer.

## Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Mbrojtja e të dhënave personale është një e drejtë themelore e individit, por dhe pse e e tillë kuadri ligjor shqiptar aktual nuk është i përafuar me “Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (në vijim “GDPR”). Në këtë mënyrë kërkohet me prioritet ky përfirim, për arsye të garantimit dhe sigurisë së të dhënave personale në funksion të modernizimit të parashikuar në dokumente strategjike kombëtare e ndërkombëtare të integritimit evropian.

Si rrjedhojë, projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” është përafuar në një pjesë të konsiderueshme me *acquis* të BE, duke sjellë risi në legjislacionin shqiptar si më poshtë:

1. E drejta për informim përmirësohet duke garantuar që informacioni i kërkuar nga subjekti i të dhënave, të jepet nga kontrolluesi në një formë koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme;
2. Përfshihen detyrime të reja për kontrolluesit dhe përpunuesit si më poshte:
  - Në rast të cënimit të sigurisë kontrolluesi njofton Komisionerin, jo më vonë se 72 orë pasi të jetë vendosur në dijeni për këtë cenim, përveç nëse nuk ka gjasa që cenimi i të dhënave të rrezikojë të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave;
  - Detyrimin e përpunuesit i cili duhet të kryejë vlerësimin e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale përpara fillimit të një procesi përpunimi me qëllim identifikimin e rreziqeve të mundshme për të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave dhe minimizimin e tyre sa më shpejt të jetë e mundur nëse rezulton se ky përpunim përbën rrezik të lartë;
  - Emërimin e një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave, i/e cili/a monitoron përputhshmërinë me këtë ligj, jep këshilla, informon dhe këshillon stafin e kontrolluesit ose të përpunuesit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave;
3. Prezantohet për herë të parë “*e drejta për t’u harruar*”, ku subjekti mund të kërkojë fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të dhe “*e drejta për transferueshmërinë e të dhënave*” e cila synon ti ofrojë mundësinë subjektit të të dhënave për të lëvizur, kopjuar ose transmetuar lehtësisht të dhënat personale nga një kontrollues tek një kontrollues tjetër për qëllime të caktuara;
4. Koncepti i mbrojtjes së të dhënave në projektim (*by design*) dhe mbrojtjes në mënyrë të paracaktuar (*by default*) është prezantuar, ku kontrolluesit dhe përpunuesit do të përpunojnë vetëm të dhëna personale, të cilat janë të nevojshme për secilin qëllim specifik të përpunimit;

## Draft Law “On the personal data protection”

The protection of personal data is a fundamental right of the individual, even though the current Albanian legal framework is not aligned with the “General Data Protection Regulation” (hereinafter “GDPR”). Thus, this adjustment is requested as a priority, regarding the guarantee and security of personal data in the function of modernization foreseen in the national and international strategic documents of European integration.

As a result, the draft law “On the personal data protection” has been aligned to a significant extent with the EU *acquis*, bringing alteration to the Albanian legislation as follows:

1. The right to be informed is enhanced guaranteeing that the information requested by the data subject is provided by the controller in a concise, transparent, understandable and easily accessible way;
2. New obligations for controllers and processors are included as follows:
  - In the event of a security breach, the controller shall notify the Commissioner, no longer than 72 hours after becoming aware of this breach, unless it is unlikely that the data breach will endanger rights and freedoms of data subjects;
  - The obligation of the processor who must carry out an protection impact assessment of personal data before starting a processing action in order to identify potential risks to the rights and freedoms of the data subject and minimize them as soon as possible if it turns out that this processing poses a high risk;
  - The appointment of a data protection officer, who monitors compliance with this law, advises, informs and advises the staff of the controller or processor regarding data protection.
3. The “right to be forgotten” is introduced for the first time, where the subject can request the deletion of personal data related to them and the “right to data *portability*” which aims to offer the possibility to the data subject to easily move, copy or transmit personal data from one controller to another controller for certain purposes;
4. The concept of data protection *by design* and protection *by default* has been introduced, where controllers and processors will only process personal data, which are necessary for each specific processing purpose;

## Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

5. Shtohet kategoria e të dhënave personale “sensitive” me “të dhëna gjenetike”, “të dhëna biometrike”, “të dhëna për orientimin seksual” dhe në të njëjtën kohë paraqitet si kusht thelbësor detyrimi i kontrolluesëve dhe përpunuesve për të garantuar masa mbrojtëse të përshtatshme me qëllim përpunimin e ligjshëm të tyre;
6. Parashikohen për herë të parë rregulla mbi përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për sigurinë publike ose kombëtare dhe për parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale në kuadër të transpozimit të Direktivës së BE 2016/680;
7. Forcohet mandati i Komisionerit në interes të pavarësisë së tij dhe zgjerohen kompetencat në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale duke përfshirë gjithashtu për herë të parë, kompetenca ndihmëse, si ato hetimore dhe korrigjuese, në funksion të përmbushjes së detyrimeve të tij;
8. Për të siguruar përputhshmëri me GDPR, sanksionet administrative rishikohen dhe vlerat rriten si më poshtë:

- a) Për shkeljet e dispozitave të cilat konsiderohen më të lehta parashikohet gjobë deri në 1.000 000 000 lekë, ose në rastin e një ndërmarrjeje, deri në 2% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës; dhe
- b) Gjoha maksimale për kundravajtjet administrative parashikohet të arrijë vlerën deri në 2 000 000 000 lekë, ose në rastin e një ndërmarrjeje, deri në 4 % të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës.

## Njoftimi paraprak mbi ndryshimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”

Ligji “Për të Drejtën e Informimit” po i nënshtrohet disa ndryshimeve. Ministria e Drejtësisë njoftoi thirrjen publike për të sjellë sugjerime që kanë për qëllim forcimin e ligjit dhe mbrojtjen më efikase të të dhënave personale të qytetarëve.

Ministria njoftoi se subjekt i ndryshimeve do të jenë kompetencat e ushtruara deri më tani nga Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale <https://konsultimpublik.gov.al>.

## Draft Law “On personal data protection”

5. The category of “sensitive” personal data is added with “genetic data”, “biometric data”, “sexual orientation data” and at the same time, the obligation of controllers and processors to guarantee appropriate protective measures is presented as an essential condition for the purpose of their legal processing;
6. Rules on the processing of personal data by the competent authorities for public or national security and for the prevention and prosecution of criminal offenses are foreseen for the first time in the framework of the transposition of EU Directive 2016/680;
7. The Commissioner's mandate is strengthened in the interest of his independence and his competencies in the field of personal data protection are expanded, including for the first time, auxiliary powers, such as investigative and corrective ones, in order to fulfill his obligations;
8. To ensure compliance with the GDPR, administrative sanctions are reviewed and increased as follow:

- a) For violations of the provisions which are considered lighter, a fine of up to ALL 1,000,000,000 is foreseen, or in the case of an enterprise, up to 2% of the total global annual turnover for the preceding financial year; and
- b) The maximum fine for administrative offenses is up to ALL 2,000,000,000, or in the case of an enterprise, up to 4% of the total global annual turnover for the preceding financial year.

## The preliminary notice on the amendment of the law “On the right to information”

The Law “On the right to information”, is undergoing various changes. The Ministry of Justice announced a call for the citizens to submit their suggestions aimed at strengthening the law as well as an efficient protection of personal data.

The Ministry put out that the legislative functions exercised so far by the Commissioner of Personal Data Protection will be subject to change <https://konsultimpublik.gov.al>.

# How can PwC Albania assist you?

## Si mund t'ju vijë në ndihmë PwC Shqipëri?

PwC mund të ndihmojë të gjitha palët e interesuara për të kuptuar se si Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” pritet të impaktojë bizneset ose start-upet tuaja dhe si të veproni që të siguronit pajtueshmërinë me parimet dhe parashikimet e tij duke përfshirë, por pa u limituar në:

- Analiza risku;
- Inventarizim të të dhënave;
- Përgatitje të politikave dhe procedurave të privatësisë së të dhënave;
- Krijim të një programi zbatimi të aktiviteteve përmirësuese për të adresuar boshllëqet e identifikuara të pajtueshmërisë me GDPR dhe ligjin vendas;
- Kryerja e funksionit të Nëpunësit të Mrojtjes së të Dhënave Personale për biznesin tuaj.

Gjithashtu PwC këshillon se kur është koha e duhur që subjektet që të konsiderojnë mbrojtjen e Pronësisë Intellektuale, përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, dhe ndjekjen e procedurave ligjore për të përfituar nga dispozitat. PwC me eksperiencën dhe ekspertizën kros-sektoriale mbetet partneri juaj i besuar për të gjithë gamën e shërbimeve taksë-audit-shërbime ligjore.

## How can PwC Albania assist you?

PwC can assist all stakeholders in understanding how the Draft Law “On Personal Data Protection” affects your businesses or startup-s and how you can ensure compliance with its principles and provisions, including but not limited to:

- Risk analysis;
- Develop of data inventories;
- Develop of data privacy policies & procedures;
- Set up an implementation programme of remedial activities to address identified compliance gaps with the GDPR and local law;
- Act like a DPO ( Data Protection Officer) for your company.

PwC can assist you as well in identifying the adequate moment that your business should consider Intellectual Property protection, preparing the necessary documentation, and following the required legal procedures to benefit from these provisions. PwC with its cross-sectoral experience and expertise remains your trusted partner for the full range of tax-audit-legal services.

# Let's talk

## **PricewaterhouseCoopers Albania**

Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower,  
9/1 Tirana, Albania

**Telephone:** +355 4 22 90 700

**Email:** [al\\_pwc\\_albania@pwc.com](mailto:al_pwc_albania@pwc.com)

**Web:** [www.pwc.com/al](http://www.pwc.com/al)

